



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 525 Akti

Nr. 609 Vendimi

Tiranë, më 22.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Pamela Qirko	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 20.12.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Alfred Konomi**, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit Alfred Konomi, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues, të datës 19.6.2020, u caktua me mirëkuptim si kryesues komisioner Roland Ilia dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e tij.
5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka administruar raportet e hartuara

nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportet e mbajtura për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe në datën 1.12.2022 vendosi: (i) përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 1.12.2022, u njoftua nëpërmjet postës elektronike me anë të së cilës është kryer komunikimi gjatë procesit të rivlerësimit mbi të drejtën e tij për të

¹ Akti i përfundimit të kontrollit me nr. *** prot., datë 7.12.2018.

paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, duke i dhënë një afat të arsyeshëm deri në datën 12.12.2022 për të paraqitur shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit.

16. Në datën 12.12.2022, përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit kërkoi zgjatje të afatit për dërgimin e shpjegimeve dhe provave për shkak të pamundësisë objektive² për t'i paraqitur brenda afatit. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të kërkesës, e gjeti të bazuar atë, duke e shtyrë brenda një afati të arsyeshëm deri në datën 16.12.2022, për të cilën subjekti u njoftua përmes postës elektronike³. Subjekti i rivlerësimit, në vijim, e ushtroi të drejtën⁴ për t'u njohur me dosjen, si dhe mori kopje të saj elektronike në datën 15.12.2022.

17. Në datën 16.12.2022 subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat nëpërmjet postës elektronike.

18. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë⁵ subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email* në datën 16.12.2022.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Alfred Konomi u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 20.12.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

20. Subjekti i rivlerësimit Alfred Konomi u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Z. Alfred Konomi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke iu përgjigjur në kohë pyetësorëve/kërkesave gjatë të gjitha fazave të hetimit administrativ, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet

² Subjekti ka kërkuar shtyrjen e afatit për të marrë disa prova/shpjegime në lidhje me pasuritë e paluajtshme që ndodhen në qytetin e Vlorës dhe në qytetin e Fierit, për të cilën i është drejtuar ASHK-së Vlorë dhe është në pritje të një përgjigjeje, duke paraqitur në cilësinë e provës shkresën nr. *** prot., datë 5.12.2022, drejtuar ASHK-së Vlorë.

³ Postë elektronike e datës 12.12.2022.

⁴ Nëpërmjet djalit të tij.

⁵ Subjekti u njoftua nëpërmjet adresës elektronike të datës 21.10.2022.

funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

22.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit, objektivitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

22.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

22.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

22.4. Ndërsa në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

22.5. Por, referuar vendimit nr. 2/2017⁶ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (e) denoncimet e publikut; (ë) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në Komision, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

⁶ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë sipas ligjit nr. 9049/2003. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

23.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja, dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në këtë institucion, duke e krahasuar me deklaratimet e interesave privatë dhe dokumentet shoqëruese dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurive për subjektin e rivlerësimit.

23.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të pasurive.

23.3. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar (në vijim *Vetting*), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar përkatësisht pasuritë/të drejtat reale, si vijon:

24. Truall me sipërfaqe 2.060 m² + ndërtesë me sipërfaqe 828.52 m², z. k. *, lagjja “***”, Vlorë, duke paraqitur si dokumentacion provues certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 23.9.2014. Pjesa takuese: 4.76%.**

24.1. Si mënyrë përfitimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: trashëgimi nga babai.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

24.2. Subjekti e ka deklaruar për herë të parë pasurinë në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë (në vijim DIPP) të vitit 2008, si vijon: *“Truall me sipërfaqe 2.060 m² së bashku me godinën e ish-shtëpisë së pushimit të punëtorëve Vlorë, lagjja “***”, Vlorë, trashëgimi nga babai. Pjesa takuese: 4.76%”.*

24.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Nuk konfirmohet nga ZVRPP-ja Vlorë pasuria e deklaruar sipas certifikatës së pronësisë paraqitur nga subjekti, kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të z. S.K (babai i subjektit).*

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri

24.4. Komisioni, si fillim, ka hetuar në lidhje me origjinën e kësaj pasurie, nga ku kanë rezultuar faktet si vijon: me vendimin nr. ***, datë 15.12.2005, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 24.12.2003, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Nga administrimi i fakteve të referuara në këtë vendim ka rezultuar se me vendimin nr. ***, datë 21.11.1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim KKKP) Vlorë ka njohur të ndjerin Dh.K (gjyshi i subjektit të rivlerësimit) si ish-pronar mbi një sipërfaqe truall prej 16.652 m², të ndodhur në lagjen “***”, të ndarë në dy parcela me sip.

11.569 m² dhe sip. 5.060 m². Nga kjo sipërfaqe i është kthyer e lirë gjithsej 10.000 m², e ndarë në dy sipërfaqe 7.000 m² dhe 3.000 m² dhe për pjesën tjetër është vendosur kompensimi.

24.5. Agjencia e Trajtimit të Pronave (në vijim ATP) konfirmon⁷ se ka njohur z. Dh.K si ish-pronar në sipërfaqe trualli pranë lagjes “****”, Vlorë, duke dërguar dokumentacionin e disponuar në lidhje me këtë vendim.

24.6. Nga administrimi i dokumentacionit vihet re se fillimisht me vendimin nr. ***, datë 30.11.1993, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së z. Dh.K mbi dy godina (njëra dykatëshe e përbërë nga 13 dhoma dhe tjetra njëkatëshe e përbërë nga 9 dhoma), të ndodhura në lagjen “****”, Vlorë, të ndërtuara në vitet 1939 - 1940, të cilat kanë qenë në përdorim nga trashëgimtarët ligjorë deri në vitin 1972, kohë kur janë shpërngulur për shkak shpronësimi.

24.7. Me vendimin nr. ***, datë 21.11.1994, KKKP-ja Vlorë ka disponuar si vijon:

- Të njohë z. Dh.K si ish-pronar mbi pasurinë truall me sip. 5.060 m² dhe sip. 11.592 m², që ndodhet në lagjen “****”, Vlorë.
- T’i kthejë në natyrë sipërfaqet e truallit prej 7.000 m² dhe 3.000 m².

24.8. Në vijim ka rezultuar se trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Dh. K, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, duke pretenduar se vendimi i KKKP-së ka qenë i padrejtë me arsyetimin se trashëgimlënësi i tyre ka qenë pronar i më shumë pronave, e kanë kundërshtuar pjesërisht këtë vendim në gjykatë. Çështja i është nënshtruar disa gjykimeve për periudhën 1996 – 2005, ku në përfundim, me vendimin nr. ***, datë 24.12.2003, të Gjykatës së Apelit Vlorë, është vendosur⁸ ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 21.11.1994, të KKKP-së Vlorë, në këtë mënyrë:

1. Pas pikës 1/a të shtohet një paragraf tjetër 1/1 me këtë përmbajtje:

*- Të njohë ish-pronarët e paditësit mbi një sipërfaqe trualli prej 3.859,5 m² e ndodhur në lagjen “****” (***), me kufizimet nga të gjitha anët me territorin e kampit të ri me dy shkallë zbritëse që zbret në rrugë, pastaj në det.*

2. Pas pikës 1/b të shtohet një paragraf i tretë, me këtë përmbajtje:

*- Sipërfaqet e trojeve 2.140 m² (mbi të cilën ndodhet godina e ***) dhe 2.060 m² (mbi të cilën ndodhet godina e ***), t’u kthehen paditësve Konomi, pasi të zgjidhen konfliktet për pronësinë e tyre midis ish-pronarëve (paditësve) dhe pronarëve të rinj, K.S dhe S.P.T⁹.*

*3. T’u kthejë paditësve sipërfaqen e truallit (****) funksionale prej 3.859,5 m² me kufizimet në territorin e *** me 2 shkallë zbritëse në rrugë, pastaj në det.*

4. Rrëzimin e padisë së paditësve për sa i përket të drejtës së parablerjes midis BSPSH-së dhe kthimit të truallit +10%.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2022.

⁸ Paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit ***.

⁹ Këto palë paraqiten në cilësinë e të paditurve, të cilët kanë pretenduar se godina e *** është në pronësi të tyre, e kaluar me Dekretin Nr. ***, datë 21.11.1994, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, i cili sipas fakteve rezulton se nuk ka marrë fuqi ligjore dhe më pas pasojat janë konsideruar nul, referuar vendimit unifikues nr. 85, datë 29.6.2001, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

5. *Kompensimin¹⁰ e paditësve për sipërfaqen 2.452 m² truall sipas disponibilitetit të KKKP-së Vlorë.*

24.9. Ky vendim është plotësuar në vijim me vendimin nr. ***, datë 17.3.2004, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me disponimin si vijon:

Pas pikës 1/b do të shtohet një paragraf tjetër me këtë përmbajtje:

- Kthimin sa më lart të trojeve me sipërfaqe 2.140 m² dhe 2.060 m² me kufizimet përkatëse dhe të brinjës (sipërfaqe funksionale 3.859,5 m²) po me kufijtë përkatës, si dhe të Godinës së Re të Sh.P.P me anekset e saj.

24.10. Në kuadër të hetimit, Komisioni ka verifikuar gjendjen e regjistrimit në sistemin elektronik multifunksional të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim ASHK), si dhe i ka kërkuar informacion ASHK-së Drejtoria Vlorë¹¹. Nga informacioni elektronik i administruar nga Komisioni, sipas nenit 50, pika 2, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, është evidentuar se pasuria vazhdon të jetë e regjistruar në emër të babait të subjektit dhe 10 trashëgimtarëve¹² ligjorë të tjerë (përkatësisht të shkallës së parë apo të dytë) të të ndjerit Dh.K. Ndërkohë që nga hetimi rezultoi se babai i subjektit kishte ndërruar jetë dhe në vijim, me vendimin nr. ***, datë 27.10.1998¹³, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë në favor të trashëgimtarëve të radhës së parë, bashkëshortes së tij D.K, të birit, subjektit të rivlerësimit Alfred Konomi dhe të bijës A.H (K), duke trashëguar secili nga 1/3 pjesë takuese. Komisioni ka konstatuar gjithashtu se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën e pasurisë së vitit 2008, ndërkohë që ka pasur detyrimin e deklarimit që në deklaratën e parë të fillimit të detyrës.

24.11. Gjithashtu, gjatë hetimit, Komisioni ka verifikuar edhe në lidhje me investimet e mundshme në ndërtesën e ngritur mbi pasurinë objekt vlerësimi, për të cilën ka pyetur¹⁴ subjektin e rivlerësimit. Pas paraqitjes së shpjegimeve se ndërtesa e quajtur “****” është administruar nga xhaxhai i tij F.K për periudhën 2004 – 2011 dhe se nuk ka pasur asnjë investim dhe përfitim të ardhurash, dhe nga administrimi i provave¹⁵ të paraqitura nga subjekti Komisioni i ka vlerësuar ato të mjaftueshme, për sa nga hetimi nuk rezultuan *indicie* për investime apo të ardhura të përfituara nga subjekti gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit si magjistrat.

24.12. Në përfundim të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me mospërputhjen e deklarimit të subjektit me dokumentacionin, pasi nga hetimi rezultoi se pasuria figuron ende e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të babait të subjektit, z. S.K.

¹⁰ Referuar dosjes së ardhur nga ATP-ja nuk evidentohet që trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar të kenë përfituar kompensim.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.9.2020, drejtuar ASHK-së Qendrore në vëmendje të drejtorive vendore dhe shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2022.

¹² Citohen: A.K, F. K, I.K, K. K, L. K, M. K, Dh.K, H. K, Gj.K dhe A.K.

¹³ Akt i paraqitur me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2022, të ILDKPKI-së.

¹⁴ Shihni përgjigjen e pyetjes nr. *** të pyetësorit ***.

¹⁵ Shihni pyetësorin ***, pyetja nr. *** dhe provat e paraqitura.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

24.13. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjekti ka shpjeguar si fillim se deklarin e pasurisë e ka kryer në vitin 2008 dhe jo në deklaratën e parë, pasi në këtë vit ka përfunduar procesi gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese.

24.14. Subjekti ka shpjeguar gjithashtu se mosregjistrimi në regjistrat publikë i pasurisë objekt vlerësimi në emrin e tij dhe trashëgimtarëve ligjorë të babait të tij nuk është kryer nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pavarësisht depozitimit të ndryshimit nga ana e tij, duke arsyetuar se babai i tij, i ndjeri S.K, është angazhuar në procesin gjyqësor për përfitimin e kësaj pasurie dhe gjatë procesit ka ndërruar jetë. Në vijim, procesi gjyqësor është ndjekur nga subjekti, nëna dhe motra e tij, të cilët janë futur me zëvendësim dhe në përfundim të procesit e kanë depozituar vendimin në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, por kjo e fundit nuk e ka regjistruar në emër të subjektit dhe trashëgimtarëve ligjorë të babait të tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

24.15. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit, si dhe e dëgjoji atë në seancën dëgjimore, çmon se në lidhje me regjistrimin e pasurisë, pavarësisht se subjekti u përpoq të shpjegonte arsyet e gjendjes faktike të pasurisë në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme, nuk arriti të provonte përpjekjet e tij për të kryer regjistrimin e saj në emrin e tij dhe trashëgimtarëve ligjorë të babait të tij. Gjithsesi, kjo situatë faktike nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, për sa provohet titulli i pronësisë mbi pasurinë dhe për sa nga hetimi nuk rezultoi ndonjë *indicie* për transferim të drejtash reale dhe përfitim të ardhurash, që të mund të vinte në dyshim gjendjen juridike të të drejtave reale të subjektit dhe, për rrjedhojë, të impaktonte në procesin e rivlerësimit që po kryhej ndaj tij.

24.16. Nga ana tjetër, trupi gjykues çmon si pasaktësi të subjektit deklarin e pasurisë në deklaratën e pasurisë të vitit 2008, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti e ka përfituar pasurinë në vitin 1998 nëpërmjet trashëgimisë ligjore, duke e bërë efektive¹⁶ të drejtën e pronësisë me vendimin nr. ***, datë 17.3.2004, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe, për rrjedhojë, bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ka pasur detyrimin e deklarin të pasurisë si pasuri e akumuluar, si dhe burimet e krijimit të saj në deklaratën e parë të pasurisë, dorëzuar nga subjekti në datën 20.3.2004. Trupi gjykues vlerëson se pas momentit kur vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë, proceset gjyqësore vijuese të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit dhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë, me pretendime të natyrës së shkeljeve procedurale apo kushtetuese, sikurse është dhe procesi gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese, i referuar nga subjekti në argumentet e tij, nuk kanë vendosur mbi të drejtën e pronësisë mbi pasurinë objekt vlerësimi.

24.17. Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludon se, pavarësisht pasaktësisë së konstatuar në deklarin, ky fakt nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të

¹⁶ Vendimi unifikues nr. 24, datë 13.3.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i ka konsideruar aktet ligjore që u drejtohen ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre jo si mënyrë të re të fitimit të pronësisë në favor të tyre, por si mjete që mbrojnë dhe garantojnë të drejtën e pronësisë dhe e bëjnë efektive atë.

nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk e ka fshehur pasurinë, si dhe nuk ka ndërmarrë veprime apo mosveprime për deklarim të rremë të saj.

25. Truall me sipërfaqe 2.140 m², z. k. *, lagjja “****”, Vlorë. Pjesa takuese: 4.76%.**

25.1. Si mënyrë përfitimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: trashëgimi nga babai.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

25.2. Subjekti e ka deklaruar për herë të parë pasurinë në DIPP/2008, si vijon: *“Truall me sip. 2.140 m², lagjja ‘***’, Vlorë, trashëgimi nga babai. Pjesa takuese: 4.76%”*.

25.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Nuk konfirmohet nga ZVRPP-ja Vlorë pasuria e deklaruar sipas certifikatës së pronësisë të paraqitur nga subjekti, kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të z. S.K (babai i subjektit).*

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri

25.4. Në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie kanë rezultuar të njëjtat fakte si në pasurinë e parë, trajtuar më lart. Pasi gjyshit të subjektit të rivlerësimit i janë njohur pronat me vendimin nr. ***, datë 21.11.1994, të KKKP-së Vlorë, trashëgimtarët ligjorë të tij janë investuar gjyqësisht për të kundërshtuar këtë vendim, ku në përfundim, me vendimin nr. ***, datë 17.3.2004, të Gjykatës së Apelit Vlorë, është kthyer pasuria objekt vlerësimi trashëgimtarëve ligjorë të gjyshit të subjektit, të ndjerit Dh.K. Subjekti i rivlerësimit e ka përfituar pasurinë në bashkëpronësi me nënën dhe motrën e tij me trashëgimi nga babai i tij, sipas vendimit nr. ***, datë 27.10.1998¹⁷, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

25.5. Më tej, Komisioni, bazuar në nenin 50, pika 2, germa “c”, ka verifikuar gjendjen e regjistrimit të kësaj pasurie në regjistrat elektronikë të pasurive të paluajtshme, nga verifikimi i së cilave evidentohet se pasuria është e regjistruar në emër të babait të subjektit dhe 10 trashëgimtarëve¹⁸ të tjerë ligjorë të të ndjerit Dh.K (përkatësisht të shkallës së parë apo të dytë). Komisionit i rezultoi se subjekti edhe këtë pasuri nuk e kishte të regjistruar në emrin e tij.

25.6. Referuar kartelës së pasurisë është shënuar se mbi pasurinë truall ndodhet objekti *** dhe dy kufizime të pronësisë me datë regjistrimi 1.8.2014, shënuar përkatësisht “ka 1 ndërtim pa leje kufizim” dhe “vendim gjyqësor për vendosjen e masës së sigurimit të padisë” me nr.***, datë 23.2.2022, me afat kufizimi 10 vjet. Kjo pasuri duket se është ndarë në dy pasuri, përkatësisht në truall me nr. pasurie *** , me sip. 1720 m² dhe truall me nr. pasurie *** , me sip. 420 m², në emër të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Dh.K. Në kartelën e pasurisë truall me sip. 1.720 m² janë shënuar specifikimet “mbi këtë truall ndodhet objekti ****” dhe “ka një ndërtim pa leje”.

25.7. Komisioni e ka pyetur subjektin dhe i ka kërkuar dokumentacion provues¹⁹ në lidhje me ndërtimet pa leje të konstatuara nga kartela e pasurisë mbi pasurinë truall, si dhe masën e

¹⁷ Akt i paraqitur me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2022, të ILDKPKI-së.

¹⁸ Shtetasit A. K, F.K, I.K, K. K, L. K, A. K, Dh.K, Gj. K, H.K dhe M.K.

¹⁹ Shihni pyetjen nr. *** të pyetësorit ***.

sigurimit të padisë të vendosur mbi të. Subjekti ka sqaruar se mbi pasurinë nr. *** ndodhen dy objekte me pronar K.S.P e Shqipërisë, sipas Dekretit të Presidentit të Republikës Nr. 204, datë 5.6.1992, “Për pasuritë e sindikatave”. Subjekti ka vijuar të shpjegojë se trualli është i regjistruar në ASHK me pronar trashëgimtarët e të ndjerit Dh.K, ndërsa ndërtesat janë regjistruar në ASHK me pronar K.S.P të Shqipërisë, me nr. pasurie *** dhe nr. pasurie ***.

25.8. Në lidhje me masën e sigurimit të padisë vendosur me vendim gjykate, subjekti ka sqaruar se trashëgimtarët e të ndjerit Dh.K kanë ngritur kërkesëpadi kundër K.S.P të Shqipërisë dhe z. A.M, me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë, vendosjen e sekuestros konservative mbi pasuritë e paluajtshme në emër të K.S të Shqipërisë”, si vijon: “1- Pasuri e llojit ndërtesë, me sipërfaqe 171 m², regjistruar në ASHK me nr. ***, vol. ***, z. k. ***, Vlorë; 2- pasuri e llojit ndërtesë, me sipërfaqe 457 m², regjistruar në ASHK, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. *** Vlorë; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2012, për pjesën që ka disponuar dhënien me qira të pasurisë truall në pronësi të familjes Konomi; 3- lirimin dhe dorëzimin e pasurisë së paluajtshme truall, të zënë nga ana e të paditurve; 4- prishjen e objekteve të ndërtuara prej të paditurit në truallin në pronësi të familjes Konomi; 5- detyrimin solidarisht të paditurve për të shpërblyer palët paditëse për përdorimin me keqbesim të truallit në pronësi të familjes Konomi, shumën 50.000.001 lekë. Ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore palëve të paditura”. Subjekti ka shtuar se çështja është në proces gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

25.9. Nga administrimi i shpjegimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit duket se mbi truallin e kthyer me vendim gjykate prej 2.140 m² ndodhen dy objekte “godinat e ***”, të cilat me Dekretin Nr. 204, datë 5.6.1992, të Presidentit, i kanë kaluar në pronësi K.S.P të Shqipërisë. Kjo e fundit, me kontratën e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2012, i ka dhënë me qira shtetasit A. M godinat së bashku me truallin. Trashëgimtarët Konomi janë investuar gjyqësisht për zgjidhjen e konfliktit të zënies së truallit të tyre, duke proceduar fillimisht me kërkimin për marrjen e masës së sigurimit të padisë e pastaj me padi themeli për lirimin e truallit dhe dëmshpërblim për përdorim me keqbesim të truallit ndaj palëve të paditura K.S.P të Shqipërisë dhe shtetasit A.M.

25.10. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin e ndërmjetëm datë 21.9.2020, ka vendosur “Pranimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë sekuestro konservative mbi pasuritë e paluajtshme; pasuri ndërtesë me sipërfaqe 171 m² dhe pasuri ndërtesë me sipërfaqe 457 m², regjistruar në ASHK-në Vlorë në emër të palës së paditur K.S.P të Shqipërisë”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 4.2.2021.

25.11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***), datë 23. 2.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit datë 21.9.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vendimit nr. ***, datë 4.2.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë, në këtë mënyrë: “1- Caktimin si masë sigurimi padie, bllokimin e pasurisë truall prej 2.140 m²; 2- heqjen e masës së sigurimit të padisë lidhur me sekuestron konservative në godinat në pronësi të K.S.P të Shqipërisë”.

25.12. Pra, nga tërësia e fakteve duket se mbi pasurinë truall objekt vlerësimi, me vendimin nr. ***, datë 23.2.2022, të Gjykatës së Lartë, është vendosur sekuestro konservative deri në zgjidhjen e konfliktit për godinat e kampit të vendosura mbi këtë truall.

25.13. Pas analizimit të fakteve të përfituara nga dokumentacioni i hetimit, si dhe ato të paraqitura nga subjekti, Komisioni i kërkoi këtij të fundit të paraqesë dokumentacion provues në formën e kërkuar nga ligji, për sa shpjegoi gjatë hetimit.

25.14. Gjithashtu, edhe për këtë pasuri, sikurse konstatuar edhe në pasurinë e parë, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime, për sa nuk përputhet deklarimi i tij me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, pasi pasuria figuron ende e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të babait, z. S. K.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

25.15. Subjekti ka shpjeguar se edhe për këtë pasuri ka kuptuar se deklarin duhet ta kryente pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe për këtë arsye e ka kryer në përfundim të procesit gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese në vitin 2008.

25.16. Në lidhje me masën e sigurimit të padisë të vendosur mbi truallin me vendimin nr. ***, datë 23.2.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, subjekti ka sqaruar se ky vendim i ndërmjetëm ndodhet në dosjen civile që po gjykohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe për të provuar vijimin e gjykimit të trashëgimtarëve Konomi kundër K.S.P të Shqipërisë dhe z.A.M subjekti paraqiti në cilësinë e provës fletë të printuara nga sistemi ICMIC i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku vërtetohet se pranë kësaj gjykate po shqyrtohet çështja civile me nr. regj. them. ***, datë 10.9.2020.

25.17. Gjithashtu, në lidhje me mosregjistrimin e pasurisë, subjekti ka sqaruar, sikurse për të gjitha pasuritë e ndodhura në lagjen “****”, se ASHK-ja Vlorë nuk e ka kryer regjistrimin në emrin e tij por në emrin e babait të tij, edhe pse është depozituar vendimi i gjykatës për njohjen e kësaj prone në favor të trashëgimtarëve ligjorë të ardhur në proces me zëvendësim. Ai ka sqaruar gjithashtu se më tej nuk ka qenë i interesuar për ndjekjen e regjistrimit, duke qenë se nuk ka pasur as burime financiare për të investuar në të.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

25.18. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit me shkrim dhe pasi e dëgjoi në seancën dëgjimore, vlerëson se subjekti shpjegoi mjaftueshëm në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie, ekzistencën e konfliktit për zënieën e truallit me ndërtime nga K.S.P të Shqipërisë, si dhe provoi administrimin e këtij konflikti nëpërmjet proceseve gjyqësore.

25.19. Për sa i përket regjistrimit të pasurisë në regjistrat publikë, trupi gjykues çmon se subjekti nuk duket të ketë pasur interes për regjistrimin përfundimtar të pjesës takuese të pasurisë në emrin e tij dhe trashëgimtarëve ligjorë të babait të tij, por fakti i publikimit nuk cenon kursesi tagrin e pronësisë së tij, si dhe nuk impakton procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, për sa kohë nga hetimi nuk u evidentuan *indicie* për transferim të drejtash reale dhe përfitim të ardhurash nga subjekti i rivlerësimit.

25.20. Në lidhje me pasaktësinë në deklaram, sikurse është analizuar edhe në pasurinë e parë, trupi gjykues çmon se mosdeklarimi në deklaratën para fillimit të detyrës, sikurse kërkohet në ligjin nr. 9049/2003, por në deklaratën e vitit 2008, nuk e penalizon subjektin e rivlerësimit bazuar në parimin e proporcionalitetit, pasi ai nuk ka ndërmarrë veprime për fshehje apo deklaram të rremë të pasurisë, por e ka deklaruar atë 4 vjet më vonë.

26. Truall me sipërfaqe 7.000 m², z. k. *, lagjja “***”, Vlorë, me trashëgimi nga babai.**
Pjesa takuese: 4.76%.

26.1. Si mënyrë përfitimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: trashëgimi nga babai.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

26.2. Subjekti e ka deklaruar për herë të parë pasurinë në DIPP/2014, si vijon: *“Truall me sip. 7.000 m², lagjja ‘***’, Vlorë, trashëgimi nga babai. Pjesa takuese: 4.76%”*.

26.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Nuk konfirmohet nga ZVRPP-ja Vlorë pasuria e deklaruar sipas certifikatës së pronësisë të paraqitur nga subjekti, kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të z. S.K (babai i subjektit).*

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri

26.4. Nga hetimi i Komisionit²⁰ ka rezultuar se pasuria truall me sip. 7.000 m² i është kthyer gjyshit të subjektit, të ndjerit Dh.K, nga KKPP-ja Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 21.11.1994, ku është vendosur, midis të tjerave²¹, të kthehet në natyrë sipërfaqja e truallit prej 7.000 m², ndodhur në lagjen “***”, Vlorë.

26.5. Subjekti e ka përfituar pasurinë me trashëgimi ligjore nga babai i tij, i ndjeri S.K, me vendimin nr. ***, datë 27.10.1998²², të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

26.6. Bazuar në nenin 50, pika 2, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, Komisioni aksesoi të dhënat elektronike të regjistruara në sistemin multifunksional të ASHK-së, nga verifikimi i së cilës evidentohet se pasuria është e regjistruar në llojin “shesh”, me nr. ***, në emër të babait të subjektit, z. S.K, dhe trashëgimtarëve ligjorë të tjerë K.L, B. K, F. K, I. K, K.K dhe L .K. Referuar kartelës së pasurisë evidentohen të shënuara kufizime pronësie “ka 2 ndërtime pa leje”. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit, ka deklaruar²³ se në pasuritë e kthyer nga KKPP-ja Vlorë dhe nga gjykatat nuk janë kryer ndërtime pa leje/me leje dhe nuk ka pasur zhvillime të mëvonshme.

26.7. Në shpjegimet përfundimtare, subjekti sqaroi se këto ndërtime të evidentuara mbi truallin i përkasin dy shtëpive të ndërtuara nga gjyshi i tij, i ndjeri Dh. K, në vitin 1932, të cilat posedohen nga trashëgimtarët e shtetasve I.K dhe B.K (të afërm të subjektit), banorë të lagjes “***”, Vlorë. Subjekti ka sqaruar më tej se në lidhje me këto ndërtesa nuk disponon certifikatë

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2022.

²¹ Për më tepër referohuni përmbajtjes së vendimit trajtuar në seksionin e pasurisë së parë.

²² Akt i paraqitur me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2022, të ILDKPKI-së.

²³ Shihni përgjigjet nr. 2.1 - 2.2.

pronësie. Për të provuar shpjegimet e tij, subjekti paraqiti kopje të aktit “kontratë pjesëtim prone”, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.7.1972, lidhur midis trashëgimtarëve të Dh.K, nga administrimi i së cilës duket se gjyshi i subjektit ka pasur në pronësi një truall prej 6 vreten sipas regjistrave publikë të vitit 1932, mbi të cilën trashëgimtarët ligjorë të tij kanë ndërtuar dy shtëpi banimi, njëra me 2 kate e përbërë nga 13 dhoma dhe tjetra 1-katëshe e përbërë nga 9 dhoma. Sipas kësaj kontrate dukej se trashëgimtarët ligjorë janë disponuar për pjesëtimin e dhomave midis tyre.

26.8. Gjithashtu, në shpjegimet përfundimtare, për sa kërkuar nga Komisioni, subjekti renditi sërish edhe për këtë pasuri të njëjtat arsye si për pasuritë e tjera të trashëguara nga gjyshi i tij, të cituara në këtë vendim, të cilat e kanë çuar në moskryerjen e regjistrimit të kësaj pasurie në emrin e tij dhe trashëgimtarëve ligjorë të babait të tij, z. S.K.

26.9. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, dhe duke pasur qëllim mosrënien në përsëritje të argumenteve, për sa nuk u diktuan problematika në lidhje me këtë pasuri, çmon përfundimisht se moskryerja e regjistrimit në regjistrat publikë si një veprim “solemn” nuk e penalizon subjektin e rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk i heq subjektit atributet e titullit të pronësisë mbi pasurinë.

27. Apartament banimi me sipërfaqe 82 m², në lagjen “*”, Fier. Vlera: 10.098 lekë. Pjesa takuese: 50%.**

27.1. Si mënyrë përfitimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: “*Përfitur me privatizim, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.1994, ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’*”. Subjekti ka paraqitur dokumentacion mbështetës, kontratën e privatizimit datë 30.12.1993, vërtetim noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.1994, për redaktim kontratë shitblerjeje dhe vërtetim regjistrimi në hipotekë datë 7.10.1994.

27.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi, ndërtuar para vitit 1990, me sipërfaqe 60 m², në bashkëpronësi me nënën time D.K, e ndodhur në lagjen ‘***’, rr. ‘***’, p. ***, Fier, me burim nga privatizimi i banesave shtetërore*”.

27.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *ZVRPP-ja Fier, në përgjigjen e saj, konfirmon se ky apartament i është shitur në datën 5.5.2004 shtetasit M. C, në vlerën 1.050.000 lekë, me shënimin “anulohet”. Kartela e pasurisë dhe kontrata e shitblerjes ka palë shitëse Dh.D dhe palë blerëse M.C.*

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri

27.4. Nga hetimi i Komisionit²⁴ në lidhje me këtë pasuri kanë rezultuar faktet se në datën 30.12.1993 është lidhur kontrata për privatizimin e banesës midis Ndërmarrjes Komunale Banesa Fier dhe babait të subjektit, të ndjerit S.K, me objekt “privatizimin e banesës nr. ***, pallati nr. ***, të ndodhur në rrugën ‘***’, Fier”. Pas shlyerjes së pagesës, referuar vërtetimit noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.1994, është lidhur kontrata e shitblerjes midis të

²⁴ Paraqitur nga subjekti, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, si dhe ai i rezultuar nga hetimi i Komisionit.

dyja palëve dhe në vijim, në datën 7.10.1994, pasuria është regjistruar në regjistrin e hipotekave.

27.5. Referuar dokumentacionit të ardhur nga ASHK Drejtoria Fier²⁵, subjekti i rivlerësimit rezultoi bashkëpronar me të ndjerin babain e tij dhe nënën D.K në pasurinë apartament me sip. 82 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. *** f. ***, me përshkrim të veçantë “përbërja 2+1”, e papajisur me certifikatë pronësie.

27.6. Sipas kartelës së pasurisë, dërguar nga ASHK-ja, është evidentuar se pasuria apartament me sip. 82 m² është regjistruar në datën 8.10.2000 dhe më pas duket se i ka kaluar shtetasit M.C, referuar regjistrimit në kartelë datë 5.5.2004, ku në të evidentohet e shënuar “anulohet”.

27.7. Sipas dokumentacionit të depozituar në regjistër në lidhje me këtë referencë, rezultoi se shtetasi M.C ka blerë nga shtetasit Dh dhe M. D me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., pasurinë apartament me nr. ***, pallati nr. ***, shk. ***, kati i ***, i përbërë nga një dhomë e një kuzhinë, e ndodhur në lagjen “****”, Fier, kundrejt vlerës 1.050.000 lekë, e cila është e regjistruar në regjistrin e hipotekave në favor të blerësit në datën 4.5.1996. Referuar këtij dokumentacioni, ky apartament ka të dhëna të ndryshme nga apartamenti në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe duket se është regjistruar gabimisht e më pas është anuluar, sikurse është cituar më lart, referuar kartelës së pasurisë.

27.8. Ky konstatim duket se përforcohet edhe më tej, ku nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me këtë transaksion shitblerjeje ka rezultuar se shtetasi M.C ka depozituar në regjistër deklaratën datë 4.5.2004, sipas së cilës për efekt reregjistrimi ai deklaroi se është pronar i pasurisë së blerë me kontratën e shitblerjes, të cituar më sipër, dhe se me këtë pasuri nuk ka bërë asnjë veprim tjetërsimi, duke vazhduar ta posedojë si pronar i ligjshëm.

27.9. Gjatë hetimit, Komisioni e ka pyetur subjektin²⁶ në lidhje me konstatimin e faktit të regjistrimit të pasurisë në emër të shtetasit M. C, si dhe të paraqiste një akt të freskët që të mund të vërtetonte pronësinë e tij mbi apartamentin objekt vlerësimi.

27.10. Subjekti ka shpjeguar²⁷ se pasuria është privatizuar në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me vlerën 10.098 lekë. Apartamenti aktualisht gëzohet dhe posedohet nga familja e tij me adresë: Njësia Administrative Nr. ***, rruga “****”, banesa nr. ***, ap. ***, hyrja ***, kati i ***, Fier. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave kontratë për privatizimin e banesës, datë 30.12.1993, vërtetuar me vërtetim hipotekor nr. *** rep., nr. *** kol, datë 6.10.1993, regjistruar në hipotekë me nr. ***, datë 7.10.1994, në regjistrin e apartamenteve.

27.11. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni, pas administrimit të dokumentacionit, pjesë e dosjes së hetimit, i kërkoi atij shpjegime, për sa duket se nuk përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, pasi pasuria nuk figuron e regjistruar në emër të tij dhe nënës së tij në 50% pjesë takuese, sikurse deklaruar, por në emër të subjektit, babait S.K

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2020.

²⁶ Shihni pyetjen nr. *** të pyetësorit ***.

²⁷ Shihni përgjigjen nr. *** të pyetësorit ***.

dhe nënës së tij, si dhe i kërkoi subjektit shpjegime shteruese, dokumentacion provues në lidhje me konstatimin e regjistrimit të pasurisë në emër të shtetasit M.C.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

27.12. Në lidhje me deklarimin e pasurisë, subjekti ka shpjeguar se ka deklaruar bashkëpronësinë në 50% pjesë takuese sepse pas vdekjes së babait S.K pjesa e tij ka kaluar te trashëgimtarët ligjorë, duke sqaruar se motra e tij A. H (K) ka hequr dorë verbalisht nga kjo pasuri.

27.13. Për sa i përket konstatimit nga Komisioni të regjistrimit të pasurisë në emër të shtetasit M. C, subjekti ka shpjeguar se duket qartë që ndërhyrja në kartelën e pasurisë është kryer nga ASHK-ja Fier, e cila, duke e konstatuar si gabim, ka vendosur shënimin “anulohet”. Për të provuar këtë sqarim, subjekti paraqiti aktin “informacion zyrtar”, datë 6.12.2022, lëshuar nga ASHK-ja Fier, sipas së cilit konfirmohet regjistrimi i pasurisë në emër të subjektit dhe dy bashkëpronarëve të tjerë, si dhe regjistrimi i kontratës së shitjes në emër të shtetasit M.H. C, me përshkrimin “anulohet”.

27.14. Në përfundim, subjekti ka theksuar se nuk ka kryer asnjë akt shitblerjeje tek asnjë shtetas dhe se ai banon me familjen e tij në këtë banesë në mënyrë të pandërprerë që nga vitit 1994 e aktualisht.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

27.15. Trupi gjykues, pasi administroi dokumentacionin e rezultuar në lidhje me këtë pasuri, shpjegimet e subjektit, si dhe e dëgjoji atë në seancën dëgjimore, çmon se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, për sa i përket pjesëve takuese në këtë pasuri, pasi nga hetimi rezultoi se pasuria është e regjistruar në emrin e tij, nënës dhe babait të tij. Pretendimi i subjektit se motra e tij A.H (K) ka hequr dorë verbalisht nga pasuria, mbetet i pabazuar në ligj dhe në prova, pasi bazuar në nenin 191, paragrafi i dytë i Kodit Civil, heqja dorë nga pronësia duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet. Nga hetimi i Komisionit nuk rezultoi ndonjë akt noterial për heqje dorë nga pronësia.

27.16. Për sa i përket regjistrimit të pasurisë objekt vlerësimi në emër të një shtetasi tjetër, trupi gjykues, bazuar në faktet e rezultuara nga hetimi, si dhe në shkresën e ASHK-së Fier, paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës, çmon se nuk disponohen të dhëna në lidhje me kalimin e të drejtave reale mbi pasurinë tek shtetas të tjerë. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se shtetasi M.C ka blerë një pasuri tjetër me të dhëna të tjera nga shtetas të tjerë dhe nga tërësia e rrethanave çmohet se ASHK-ja duket se ka kryer gabim material në regjistrim, të cilin e ka korrigjuar në vijim më shënimin “anulohet”.

27.17. Në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson përfundimisht se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë për pjesët takuese të bashkëpronësisë në këtë pasuri, por kjo pasaktësi nuk e bën të pamjaftueshëm deklarimin e tij, në kuptim të nenit 61, pika 3 dhe nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti e ka deklaruar pasurinë, si dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me përfitimin e saj. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion, duke pasur parasysh edhe faktin se nga hetimi nuk rezultoi ndonjë *indicie* apo rrethanë që të

mund të justifikonte përmbajtjen e ndonjë qëllimi të subjektit të rivlerësimit për deklarim të rremë të kësaj pasurie.

28. Automjet tip “**”,** prodhim i vitit 1999. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

28.1. Si mënyrë përfitimi subjekti ka deklaruar “blerë me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë 19.11.2009”.

28.2. Burimi i krijimit: kursime nga paga.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

28.3. Subjekti e ka deklaruar pasurinë në DIPP/2009, si vijon: “Autoveturë e blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009, te noteri D. L, Fier, e regjistruar në DRTSH Rrugor Fier. Vlera: 500.000 lekë”.

28.4. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e DPSHTRR-së.*

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri

28.5. DPSHTRR-ja²⁸ ka konfirmuar regjistrimin e automjetit në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 24.11.2009.

28.6. Nga administrimi i dokumentacionit në dosjen e hetimit ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009, shtetasi Dh.D i ka shitur subjektit të rivlerësimit automjetin tip “****”, kundrejt çmimit 500.000 lekë, të paguar jashtë zyrës noteriale. Automjeti si fillim është porositur në Gjermani dhe pasi janë kryer procedurat e zhdoganimit i është shitur shtetasit Dh.D kundrejt vlerës 2.150 euro, në datën 11.11.2009.

28.7. Bazuar në deklarin e subjektit të rivlerësimit, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve paraprakë financiarë për periudhën 1.1.2009 – 19.11.2009, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 500.000 lekë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi – automjet tip “****”, të pasqyruar në tabelën si vijon:

Tabela nr. 1

	1.1.2009 – 19.11.2009
A) PASURI	765,143
Autoveturë tip “****”, me targa FR *** , prodhimi i vitit 1999. Blerë me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.11.2009, me kursime nga paga. Vlera: 500.000 lekë.	500,000
Ndryshim likuiditeti	265,143
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	765,143
D) TË ARDHURA	1,493,017
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	926,537

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020.

Të ardhura nga paga, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	566,480
E) SHPENZIME	654,480
Shpenzime minimale jetike	546,480
Shpenzime arsimit për fëmijët	108,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	73,394

28.8. Nga analiza financiare e kryer për periudhën 1.1.2009 – 19.11.2009, dukej se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen në datën 19.11.2009 të automjetit tip “****”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera.

28.9. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

29. Depozitë kursimi²⁹ në “Credins Bank”, me nr. llogarie *, në shumën 353.381 lekë, pa deklaruar burimin e krijimit.**

29.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

- Në deklaratën e parë të depozituar në ILDKPKI në datën 20.3.2004, subjekti ka deklaruar në seksionin “Likuiditete” depozitë bankare në Bankën e Kursimeve Fier, në shumën 655.000 lekë.
- Në DIPP/2004, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime në këtë pasuri.
- Në DIPP/2005, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë depozite në ‘Credins Bank’, shuma 6.888 lekë, me burim krijimi kursimet e familjes dhe interesat bankare”.*
- Në DIPP/2006, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *“Pakësim në librezën e kursimit në ‘Credins Bank’ deri në datën 31.12.2006, shuma 300.000 lekë”.*
- Në DIPP/2007, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë në depozitë në ‘Credins Bank’ deri më 31.12.2007, shuma 35.026 lekë”.*
- Në DIPP/2008, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *“Depozitë në ‘Credins Bank’, shtuar nga interesat bankare shuma 19.600 lekë”;*
- Në DIPP/2009, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *“Depozitë në ‘Credins Bank’ Fier, shtuar nga interesat bankare shuma 22.935 lekë”.*
- Në DIPP/2010, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *“Depozita ime në ‘Credins Bank’ Fier, shtuar nga interesat bankare shuma 28.392 lekë”.*

²⁹ Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në seksionin “Të dhëna konfidenciale”.

- Në DIPP/2011, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *“Depozita ime në ‘Credins Bank’ Fier, shtuar nga interesat bankare për vitin 2011 shuma 24.700 lekë”*.
- Në DIPP/2012, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë depozite në ‘Credins Bank’ Fier, nga interesat e vitit 2012, shuma 26.590 lekë”*.
- Në DIPP/2013, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë depozite në ‘Credins Bank’ Fier (interesat e vitit 2013), shuma 24.885 lekë”*.
- Në DIPP/2014, në seksionin “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë në depozitën time nga interesat e vitit 2014 në ‘Credins Bank’ Fier, shuma 14.615 lekë”*.
- Në DIPP/2015, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: *“Pakësim në depozitë ‘Credins Bank’, në shumën 150.000 lekë”*.

29.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e “Credins Bank”.*

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri

29.3. “Raiffeisen Bank”³⁰ (ish-Banka e Kursimeve) konfirmon së në datën 1.10.2004 subjekti ka pasur të mbartur shumën prej 660.566 lekësh dhe se në fund të vitit 2004 gjendja në këtë llogari ka qenë 600.000 lekë, e cila më tej është tërhequr plotësisht nga subjekti në datën 25.8.2005.

29.4. “Credins Bank”³¹ konfirmon se në datën 25.8.2005 subjekti i rivlerësimit ka hapur llogarinë në monedhën lekë, duke depozituar vlerën 600.000 lekë. Referuar lëvizjeve të kësaj llogarie, balancat e gjendjeve në fund të çdo viti (për vitet 2005 – 2016) janë si vijon: (i) në datën 31.12.2005, në shumën 606.888 lekë; (ii) në datën 31.12.2006, në shumën 324.762 lekë; (iii) në datën 31.12.2007, në shumën 335.026 lekë; (iv) në datën 31.12.2008, në shumën 354.627 lekë; (v) në datën 31.12.2009, në shumën 378.562 lekë; (vi) në datën 31.12.2010, në shumën 404.115 lekë; (vii) në datën 31.12.2011, në shumën 428.847 lekë; (viii) në datën 31.12.2012, në shumën 452.779 lekë; (ix) në datën 31.12.2013, në shumën 477.634 lekë; (x) në datën 31.12.2014, në shumën 492.250 lekë; (xi) në datën 31.12.2015, në shumën 349.984 lekë; dhe (xii) në datën 31.12.2016, në shumën 353.381 lekë.

29.5. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë konstatohet se depozita fillimisht ka qenë ekzistuese në vlerën 655.000 lekë në ish-Bankën e Kursimeve që prej vitit 2003, aq sa është deklaruar nga subjekti në deklaratën e parë. Në vitin 2004 kjo depozitë është pakësuar me 55.000 lekë. Në vijim e gjithë shuma e mbetur prej 600.000 lekësh duket se është tërhequr nga “Raiffeisen Bank” në datën 25.8.2005 dhe po brenda të njëjtës ditë është depozituar në “Credins Bank”.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.9.2020.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.12.2020.

Mbi këtë shumë janë akumuluar interesa në shumën 6.888 lekë. Në datën 31.12.2005 depozita ka arritur në shumën 606.888 lekë. Gjendja e depozitës në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ka qenë në vlerën 353.381 lekë, aq sa është deklaruar nga subjekti.

29.6. Bazuar në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga dosja e hetimit, Komisioni përgatiti analizën financiare për investimin në depozita të subjektit dhe personit të lidhur me të për vitet 2003 - 2016³².

29.7. Nga analiza financiare e kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur mundësi financiare për të investuar në depozita në çdo vit, duke filluar nga vitet 2003 - 2016.

29.8. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.

30. Depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”, Fier³³, me nr. llogarie *, në shumën 108.000 lekë.** Kjo depozitë është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit si person i lidhur me të.

30.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

- Në DIPP/2008³⁴, subjekti ka deklaruar: *“Kursime nga paga e bashkëshortes gjatë viteve 2005 deri në datën 31.12.2008, në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ në shumën 550.775 lekë”*.
- Në DIPP/2009³⁵, subjekti ka deklaruar: *“Depozitë e bashkëshortes në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ në vlerën 204.536 lekë”*.
- Në DIPP/2010³⁶, subjekti ka deklaruar: *“Depozitë e bashkëshortes në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, Fier, shtuar nga interesat bankare shuma 11.863 lekë”*.
- Në DIPP/2011³⁷, subjekti ka deklaruar: *“Depozitë e bashkëshortes në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, Fier, shtuar nga interesat bankare për vitin 2011 shuma 26.585 lekë”*.
- Në DIPP/2012³⁸, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë depozite e bashkëshortes në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, Fier, nga interesat e vitit 2012, shuma 11.395 lekë”*.
- Në DIPP/2013³⁹, subjekti ka deklaruar: *“Shtesë depozite e bashkëshortes në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, Fier (interesat e vitit 2013), shuma 8.430 lekë”*.
- Në DIPP/2014⁴⁰, subjekti ka deklaruar: *“Tërheqje nga depozita e bashkëshortes në ‘Intesa Sanpaolo Bank’, Fier, deri më 31.12.2014, shuma 37.700 lekë”*.

³² Shihni tabelën përfundimtare bashkëlidhur vendimit.

³³ Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, në seksionin “Të dhëna konfidenciale”.

³⁴ Në seksionin “Të ardhura dhe angazhime në veprimtari publike dhe/ose private”.

³⁵ Në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”.

³⁶ Në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”.

³⁷ Në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”.

³⁸ Në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”.

³⁹ Në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”.

⁴⁰ Në seksionin “Të ardhura dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”.

- Në DIPP/2015⁴¹, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar: “*Shtesë depozite në ‘Intesa Sanpaolo Bank’ nga interesat e vitit 2015, shuma 130.58 lekë*”.

30.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

- *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ‘Intesa Sanpaolo Bank’.*

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri

30.3. “Intesa Sanpaolo Bank”⁴² konfirmon se në vitin 2005 personi i lidhur ka hapur llogari me nr. *** dhe se nga verifikimi i lëvizjeve së kësaj llogarie balancat e gjendjeve në fund të çdo viti (për vitet 2005 – 2016) janë si vijon: (i) në datën 31.12.2005, në shumën 153.195 lekë; (ii) në datën 31.12.2006, në shumën 210.593 lekë; (iii) në datën 31.12.2007, në shumën 369.267 lekë; (iv) në datën 31.12.2008, në shumën 550.775 lekë; (v) në datën 31.12.2009, në shumën 218.695 lekë; (vi) në datën 31.12.2010, në shumën 200,000 lekë; (vii) në datën 31.12.2011, në shumën 200.000 lekë; (viii) në datën 31.12.2012, në shumën 200.000 lekë; (ix) në datën 31.12.2013, në shumën 181.700 lekë; (x) në datën 31.12.2014, në shumën 150.000 lekë; (xi) në datën 31.12.2015, në shumën 130.013 lekë; dhe (xii) në datën 31.12.2016, në shumën 108.513 lekë.

30.4. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive në raport me deklaratimet e subjektit, u evidentua se personi i lidhur me të nuk ka deklaruar gjendjen e llogarisë në deklaratat periodike përkatëse të vitit 2005, 2006 dhe 2007, por gjatë hetimit Komisioni konstatoi se subjekti është pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁴³ në lidhje me këtë fakt, ku ka sqaruar se: “*Kam deklaruar të ardhurat nga paga rregullisht të mijat dhe bashkëshortes dhe kam menduar se edhe gjendja e llogarisë së pagës ka qenë e përfshirë*”.

30.5. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se në këtë llogari kreditohet paga e personit të lidhur në “Intesa Sanpaolo Bank” si punonjëse e DRSSH-së Fier dhe se nuk u identifikuan *indicie* për ndonjë burim tjetër të ardhurash në të. Gjithashtu, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga hetimi i Komisionit.

ÇËSHTJE TË TJERA

31. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, bazuar në nenin 50, pika 2, germa “c”, ka aksesuar të dhënat elektronike të regjistruara në sistemin multifunksional të ASHK-së në lidhje me pasuritë e ndodhura në lagjen “****”, Vlorë. Nga verifikimi i të cilit është evidentuar se në z. k. ***, Vlorë, figuron e regjistruar një pasuri truall me sip. 2.900 m², me nr. pasurie ***, në pronësi të babait të subjektit dhe trashëgimtarëve ligjore të të ndjerit Dh. K.

31.1. Gjithashtu, po nga hetimi administrativ i Komisionit, është konstatuar se me vendimin nr. ***, datë 21.11.1994, të KKKP-së Vlorë, i është kthyer trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit

⁴¹ Në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2020, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.9.2020.

⁴³ Procesverbali i datës 18.3.2015, dërguar nga ILDKPKI-ja me anë të shkresës nr. *** prot., datë 30.9.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.10.2022.

Dh.K edhe një sipërfaqe trualli prej 3.000 m², të cilën subjekti nuk e ka deklaruar në asnjë deklaratë pasurie.

31.2. Komisioni e ka pyetur subjektin⁴⁴ në lidhje me të dyja pasuritë e konstatuara, i cili ka shpjeguar se trualli me sip. 2.900 m² është i njëjtë me truallin me sip. 3.000 m², që u është kthyer trashëgimtarëve Konomi me vendimin nr. ***, datë 21.11.1994, të KKKP-së, Vlorë, por kjo pasuri nuk është regjistruar në ASHK. Në lidhje me regjistrimin e kësaj pasurie është investuar kushërira e tij, znj. K. L (K), vajza e xhaxhait, e cila ka kërkuar regjistrimin në rrugë administrative, duke qenë se pasuria në ZVRPP-në Vlorë aktualisht figuron me pronar “shtet”. Subjekti paraqiti dokumentacion provues jo në formën e kërkuar nga ligji.

31.3. Komisioni, në rezultatet e hetimit, i kërkoj subjektit paraqitjen e dokumentacionit të plotë provues, si dhe të provonte veçanërisht se pasuria truall me sip. 2.900 m² është e njëjtë me truallin me sip. 3.000 m², kthyer me vendim të KKKP-së Vlorë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

31.4. Në shpjegimet e tij, subjekti ka theksuar se pasuria truall me sip. 2.900 m² është e njëjta me pasurinë truall me sip. 3.000 m², e përfituar me vendimin nr. ***, datë 21.11.1994, të KKKP-së Vlorë, por ky truall është regjistruar në ASHK-në Vlorë me nr. ***, me sip. 2.900 m².

31.5. Sipas vendimit nr. ***, datë 21.11.1994, të KKKP-së Vlorë, ky truall kufizohet si vijon: jugu, Sh.P.P Vlorë; perëndimi, rruga e shtëpisë së pushimit (sot pasuria nr. ***), e cila i është kthyer familjes Konomi me vendim gjykate. Pasuria nr. *** kufizohet në perëndim me pasurinë nr. ***, *** Vlorë. Subjekti paraqiti si prova ortofoto të vendndodhjes së pasurisë në raport me pasuritë e tjera të regjistruara dhe ankim administrativ të shtetasës K.L drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për të provuar përpjekjet për regjistrimin në rrugë administrative të kësaj pasurie.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

31.6. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet dhe aktet e paraqitura nga subjekti, si dhe analizoi faktet e rezultuara nga hetimi, çmon se ka të dhëna se pasuria truall me sip. 2.900 m², e ndodhur në lagjen “***”, regjistruar me nr. pasurie ***, është e njëjta me pasurinë truall me sip. 3.000 m², kthyer me vendimin nr. ***, datë 21.11.1994, të KKKP-së Vlorë, trashëgimtarëve Konomi.

31.7. Nga administrimi i akteve të paraqitura nga subjekti duket se pasuria truall me sip. 3.000 m², e kthyer me vendim të KKKP-së Vlorë, në fillim ka qenë e regjistruar me nr. ***, pra me të njëjtin numër që disponon edhe pasuria truall prej 2.900 m², rezultuar nga hetimi i Komisionit. Referuar fakteve të paraqitura në ankimin administrativ të paraqitur nga subjekti, duket se në lidhje me këtë pasuri ka pasur dinamikë regjistrimesh, të cilat kanë diktuar ndjekjen administrativisht për regjistrimin efektiv të saj në favor të trashëgimtarëve ligjorë të familjes Konomi.

⁴⁴ Shihni pyetjen nr. *** të pyetësorit ***.

31.8. Pavarësisht kësaj dinamike, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë këtë pasuri në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës, por mosdeklarimi nuk e penalizon subjektin në kuptim të ligjit nr. 84/2016, bazuar në parimin e proporcionalitetit, pasi nga hetimi evidentohet burimi i krijimit të pasurisë dhe regjistrimi i saj në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme.

32. Gjatë hetimit administrativ Komisioni ka evidentuar të regjistruar në sistemin elektronik të ASHK-së një pasuri të llojit “truall” me sip. 2.733 m², me nr. ***, të ndodhur në Vlorë, në pronësi të babait të subjektit dhe trashëgimtarëve ligjorë të familjes Konomi. Kjo pasuri konstatohet se nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

32.1. Nga verifikimi i kartelës së pasurisë vihet re se kjo pasuri është ndarë në dy pjesë, përkatësisht njëra me sip. 1.366,82 m², me nr. pasurie ***, dhe tjetra me sip. 1.366,82 m², me nr. pasurie ***. Mbi këtë truall evidentohen tri ndërtime pa leje.

32.2. Komisioni e ka pyetur⁴⁵ subjektin e rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri, i cili ka shpjeguar se fillimisht është regjistruar në ZVRPP-në Vlorë, në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 20.4.2004, me sip. 3.859,5 m², në bazë të vendimit nr. ***, datë 24.12.2003, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Kjo pasuri ka marrë numrin ***. Më pas, pasuria nr. *** është ndarë në dy pasuri, përkatësisht pasuria me nr. ***, me sip. 1.182,54 m², dhe pasuria me nr. ***, me sip. 2.676,96 m². Subjekti ka shpjeguar më tej se pasurinë prej 3.859 m², pra pjesën takuese të tyre që kanë përfituar si bashkëpronarë, e ka dhuruar bashkë me nënën dhe motrën e tij tek vajza e xhaxhait K.L (K) me kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2016 dhe kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2016.

32.3. Në lidhje me tri ndërtimet pa leje të ndodhura mbi truallin me nr. pasurie ***, subjekti ka sqaruar se ndërtimet i ka kryer shtetasi F.V, i cili e ka zaptuar pasurinë e familjes Konomi dhe ka aplikuar për legalizim të objekteve pa leje. Në lidhje me këto ndërtime, më tej, ka sqaruar se kushërira e tij K.L (K) i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi kundër shtetasit F.V për anulimin dhe përjashtimin nga procesi i legalizimit të objektit të ndërtuar pa leje dhe lirimimin e dorëzimit të sendit truall të zaptuar nga ky shtetas. Subjekti ka konkluduar se aktualisht objektet pa leje janë prishur nga ndërhyrja e INUK-ut në kohën që filloi ndërtimi i *** në Vlorë, pavarësisht se në hartën e ASHK-së ekzistojnë ende.

32.4. Nga ana tjetër, gjatë hetimit administrativ të Komisionit⁴⁶ është evidentuar se me kontratat e dhurimit të datës 4.2.2016, përkatësisht kontratën e dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol. dhe kontratën e dhurimit nr. *** rep., *** kol., subjekti i rivlerësimit, bashkë me nënën dhe motrën e tij, i kanë dhuruar pjesën e tyre takuese të pasurisë truall me sip. 2.676 m² dhe të pasurisë truall me sip. 1.182,54 m², pra në total truall me sip. 3.858 m², të ndodhur në lagjen “***”, Vlorë, shtetasve K dhe P.L.

32.5. Komisioni e ka pyetur subjektin në lidhje me arsyet e dhurimit, i cili ka shpjeguar si fillim se shtetasja K.L është vajza e xhaxhait të tij, z. A. K, dhe bashkëpronare në pjesën e xhaxhait, ndërsa z. P.L është bashkëshorti i saj, i cili ka qenë edhe përfaqësuesi me prokurë të posaçme në kontratë i znj. K.L. Në lidhje me arsyet e dhurimit, subjekti ka sqaruar se sipas kontratave

⁴⁵ Shih pyetësin nr. ***, pyetja nr. ***.

⁴⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2020, të Ministrisë së Drejtësisë.

të dhurimit i kanë dhuruar pjesën e tyre takuese kushërirës së saj, pasi ajo ka marrë përsipër të shlyejë të gjitha detyrimet që i takojnë atyre si trashëgimtarë të babait të subjektit, z. S.K, në lidhje me regjistrimet e pronave të kthyera nga KKKP-ja Vlorë, si dhe për ato që do të përfitojnë në të ardhmen deri në vlerën e sendit të dhuruar.

32.6. Për sa i përket deklarimit të kësaj pasurie, Komisioni ka konstatuar se subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP/2008 me përshkrimin “*Truall me sip. 3.859 m². Lagjja “****” Vlorë. Trashëgim nga babai, me pjesë takuese 4,76%*”. Ndërsa në DIPP/2016 ka deklaruar se ka pakësuar pjesën takuese të truallit me sip. 1.182 m² me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 4.2.2016, si dhe me sip. 2.676 m² me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 4.2.2016.

32.7. Në lidhje me këtë pasuri, pas administrimit të fakteve të rezultuara nga hetimi, si dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni i kërkoi të provojë se pasuria truall me sip. 2.733 m² është e njëjtë me pasurinë truall me sip. 3.859,5 m², e kthyer trashëgimtarëve ligjorë të familjes Konomi me vendimin nr. ***, datë 24.12.2003, të Gjykatës së Apelit Vlorë, si dhe të provojë me dokumentacion provues se ndërtimet pa leje të evidentuara mbi truallin prej 3.859,5 m² janë kryer nga shtetasi F.V.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

32.8. Subjekti, në shpjegimet përfundimtare, ka vënë theksin tek fakti se pasuria me sip. 2.733 m² është e njëjtë me pasurinë me sip. 3.859,5 m², e kthyer në bazë të vendimit nr. ***, datë 24.12.2003, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Regjistrimi fillestar në ZVRPP-në Vlorë është bërë me vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. ***, datë 20.4.2004. Kjo pasuri pas regjistrimit ka marrë numrin ***, e cila është ndarë në dy pasuri të tjera: pasuria nr. *** me sip. 1.182,54 m², me “certifikatë për vërtetim pronësie” ***; dhe pasuria nr. *** me sip. 2.676,96 m², me “certifikatë për vërtetim pronësie” ***. Të dyja këto pasuri arrijnë sipërfaqen prej 3.859,5 m². Subjekti ka theksuar gjithashtu se pikërisht këto pasuri janë dhuruar te kushërira e tij, znj. K. L (K), me kontrata dhurimi, të cilat janë administruar gjatë hetimit administrativ të Komisionit.

32.9. Në lidhje me tri ndërtimet pa leje të ndodhura mbi truallin objekt vlerësimi, subjekti ka shpjeguar se këto ndërtime i ka kryer shtetasi F.V, i cili e ka zaptuar pasurinë e familjes Konomi dhe ka aplikuar për legalizim të objekteve pa leje. Në lidhje me këto ndërtime, kushërira e tij, znj. K. L (K), i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me të paditur shtetasin F.V, për anulimin dhe përjashtimin nga procesi i legalizimit të objektit të ndërtuar pa leje dhe lirim e dorëzimin e sendit truall të zaptuar. Subjekti i ka bërë me dije Komisionit gjithashtu se objektet pa leje janë prishur nga ndërhyrja e INUK-ut në kohën që filloi ndërtimi i *** në Vlorë. Për të provuar shpjegimet e tij në lidhje me ndërtimet e kryera pa leje nga shtetasi F.V, subjekti paraqiti aktet e kërkesëpadisë të shtetases K.L, me palë të paditur z. F.V dhe ALUIZNI Vlorë, si dhe vendimin nr. ***, datë 12.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

32.10. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, çmon se ka rrethana që krijojnë mjaftueshëm bindjen se pasuria me sip. 2.733 m² është e njëjtë me pasurinë me sip. 3.859,5 m², të cilën subjekti ia ka dhuruar kushërirës së tij, znj. K. L (K), me kontratat e dhurimit të datës 4.2.2016.

32.11. Ndërsa, për sa i përket ndërtimeve pa leje të evidentuara mbi këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se subjekti arriti të provonte nëpërmjet ankimit administrativ dhe vendimit të gjykatës, të paraqitura në cilësinë e provave, se trashëgimtarët Konomi kanë një konflikt me shtetasin Fitim Veizaj në lidhje me ndërtimet e kryera mbi pasurinë truall me sip. 3.859,5 m².

33. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit janë konstatuar disa transaksioneve bankare me vlera të konsiderueshme, në llogarinë e nënës së subjektit, znj. D.K.

33.1. Komisioni, në kuptim të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, pavarësisht se ka konstatuar se nëna e subjektit nuk është person i lidhur me të, e ka pyetur subjektin, si dhe ka hetuar⁴⁷ në drejtim të konfliktit të interesit me shtetasit e cituar në transaksionet bankare. Në përfundim të hetimit, Komisioni ka vlerësuar të mos thellohet më tej, duke qenë se nuk u evidentua ndonjë dyshim për fshehje pasurie të subjektit të rivlerësimit, si dhe ndonjë konflikt interesi të tij me shtetasit e përfshirë në këto transaksione.

ANALIZA FINANCIARE

34. Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën 2003 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve për vitet 2003 - 2016.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë

35. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në lidhje me pasuritë e deklaruara/rezultuara nga hetimi administrativ, çmon se në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit pasuror janë evidentuar disa pasaktësi në deklaram nga ana e subjektit, të cilat nuk kanë sjellë pasoja negative në vlerësimin pasuror të kryer ndaj tij.

35.1. Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan *indicie* për pasuri të fshehura apo deklaram të rremë të subjektit. Subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

35.2. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

36. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ai ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 2.11.2017.

⁴⁷ Shkresë nr. **** prot., datë 31.10.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

37. Pas kërkesës së Komisionit⁴⁸ për deklasifikimin dhe përditësimin e raportit për kontrollin e figurës, DSIK-ja⁴⁹ ka dërguar raportin për kontrollin e figurës, me informacione të përditësuara, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 19.8.2022, të KDZH-së, sipas të cilit bëhet me dije se: *“Për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Konomi, disponohen të dhëna për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formë e shpërdorimit të detyrës, me qëllim dhënien e një vendimi në favor të një pale. Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Alfred Konomi, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit”*.

Hetimi i Komisionit

38. Komisioni, pasi u njoh me raportin e përditësuar të DSIK-së dhe informacionet përkatëse, kërkoi⁵⁰ dhe administroi praktikën gjyqësore. Nga hetimi i kryer nuk u evidentuan rrethana apo fakte, të cilat mund të përbënin *indicie* për hetime të mëtejshme për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

39. Në përfundim, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të dhënat e kërkuara në deklaratën e kontrollit të figurës.

39.1. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

39.2. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Alfred Konomi ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

40. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale⁵¹, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short; si dhe (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

41. Referuar raportit, të hartuar mbi bazën e kriteve të vlerësimit, sipas pikës 1 të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Identifikon normën ligjore të

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 13.5.2022.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.8.2022.

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁵¹ Raporti nr. *** prot., datë 2.6.2021.

zbatueshme, si dhe ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Për sa i përket kriterit të aftësisë organizative, vihet re se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi për të kryer procedurat dhe për të administruar dosjet gjyqësore. Nga verifikimi i “regjistrimit të ankesave dhe procedimeve disiplinore”, si dhe referuar pesë dosjeve të vëzhguara, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të subjektit të rivlerësimit. Subjekti ruan paanësinë në gjykim, si dhe respekton barazinë e palëve.

42. Referuar të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë për subjektin e rivlerësimit.

Rivlerësimi profesional i kryer nga Komisioni

43. Komisioni verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur dokumentet që kanë shërbyer për kryerjen e vlerësimit profesional ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin që ka shërbyer si burim arkivor në lidhje me ankesat/kërkesat për përjashtim, të dhënat në lidhje me regjistrin e procedimeve disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

44. Nga analizimi i dokumentacionit u evidentuan se në tri dokumentet ligjore, paraqitur nga subjekti për efekt të rivlerësimit kalimtar, gjykimi është realizuar në shkelje të afatit standard 6-mujor⁵², të përcaktuar në pikën 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve. Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime për secilin gjykim, për arsyet e tejkalimit të afatit ligjor.

45. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, ndaloi në secilën çështje, duke parashtruar arsyet që e kanë çuar në shtyrjen në kohë të gjykimeve, si kryerja e njoftimit me shpallje të palëve, caktim i ekspertëve, duke i dhënë palëve kohë të mjaftueshme për ushtrimin e të drejtave ligjore të mbrojtjes, mungesa e avokatëve të palëve, e të tjera shkaqe të kësaj natyre. Trupi gjykues, pasi administroi argumentet e subjektit në lidhje me shkaqet ligjore për shtyrjen e seancave, i gjeti ato bindëse.

46. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni është ndalur edhe në analizimin e të dhënave nga burimet arkivore, që lidhen me dosjen personale të subjektit të rivlerësimit. Nga të dhënat e

⁵² Çështja 1 – gjykimi i çështjes në lidhje me vendimin gjyqësor civil nr. ***, datë 12.10.2015, për çështjen civile me nr. regj. them. ***, datë regjistrimi 12.1.2015, që iu përket palës paditëse B.S, R.T (S), kundër të paditurve S.S, S. S, person i tretë shoqëria përmbarimore “****” sh.p.k., me objekt “Përjashtim i sendit, sipërfaqes së tokës prej 565 m² nga ekzekutimi. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 17.12.2007”, ka zgjatur 9 muaj, në intervalin kohor 12.1.2015 – 12.10.2015.

Çështja 2 – gjykimi i çështjes në lidhje me vendimin gjyqësor civil nr. *** datë 17.12.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për çështjen civile me nr. regj. them. ***, datë regjistrimi 2.6.2015, që iu përket palës paditëse B.N, L.N, kundër të paditurve R. R, E. R, Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (ish-Banka Credit Agricole sh.a.) dhe shoqëria përmbarimore gjyqësore “****” sh.p.k., person i tretë ZVRPP-ja Fier, me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore, vendim shpallje të shitjes në ankand të pasurisë apartament me sip. 124,36 m²”, etj., ka zgjatur 6 muaj e 15 ditë, në intervalin kohor 2.6.2015 – 17.12.2015.

Çështja 3 – gjykimi i çështjes në lidhje me vendimin gjyqësor civil nr. ***, datë 24.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për çështjen civile me nr. regj. them. ***, datë regjistrimi 19.5.2015, që iu përket palës paditëse M. G, ndërhyrës dytësorë L. G, E.G dhe E.G, kundër të paditurit shoqëria “****” sh.a. P, person i tretë Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, me objekt “Konstatim i faktit të diskriminimit dhe viktimizimit ndaj paditësit” etj., ka zgjatur 9 muaj e 5 ditë, në intervalin kohor 19.5.2015 – 24.2.2016.

analizuara është evidentuar se në vitin 2001 subjektit i është dhënë masa disiplinore⁵³ “vërejtje me paralajmërim”. Pas administrimit⁵⁴ të praktikës në lidhje me masën e dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe njohjes me shkaqet që lidhen me zvarritjen e disa proceseve gjyqësore kryesisht gjatë viteve 2000 dhe 2001, Komisioni çmoi të mos thellohej më tej në kuadër të kriterit të vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit, pasi shkeljet e kryera i përkasin një periudhe jashtë objektit të rivlerësimit kalimtar, bazuar në nenin 41, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe, gjithashtu për këto shkelje, subjektit i është dhënë një masë disiplinore nga organi kompetent, në atë kohë Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

47. Në kuadër të hetimit për kontrollin e figurës, Komisioni ka tërhequr⁵⁵ praktikën gjyqësore që lidhet me çështjen gjyqësore civile me nr. ***, datë 5.6.2019, me objekt “shpërblim dëmi”, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të cilën e ka administruar dhe analizuar në kuptim të kriterëve të vlerësimit profesional. Nga analizimi i kësaj dosjeje gjyqësore nuk u gjetën *indicie* që të mund të përbënin shkelje për subjektin e rivlerësimit.

48. Në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe shtatë denoncime⁵⁶ për subjektin e rivlerësimit. Nga administrimi dhe vlerësimi i secilit denoncim, në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk u gjetën *indicie* për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

49. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

49.1. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimi ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

⁵³ Me vendimin nr. ***, datë 19.11.2001, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2022, e KLGJ-së.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁵⁶ 1) Denoncim i shtetasit B. L, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 3.2.2021, i cili ka denoncuar subjektin për dhënie vendimi të padrejtë; (2) denoncim i shtetasit Q.H, protokolluar me nr. *** prot., datë 13.6.2018, i cili ka denoncuar subjektin për dhënie vendimi të padrejtë, të pabazuar në prova dhe për vendim të njëanshëm në çështjen ku ai ka qenë palë gjyqësore; (3) dy denoncime të shtetasit R.B, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot. dhe me nr. *** prot., datë 11.6.2021, i cili ka denoncuar subjektin për vendim të padrejtë; (4) denoncim i shtetasit B. J, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 4.7.2018, i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë dhe të njëanshëm; (5) denoncim i shtetasit A. B, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 23.4.2019, i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë, në shkelje të ligjit; (6) denoncim i shtetasit L.B, protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 18.5.2018, për vuajtje dënimi të padrejtë.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se subjekti ka arritur në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në të tria kriteret:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 2, si dhe nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Alfred Konomi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë në datën 22.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Pamela QIRKO
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANALIZA FINANCIARE PERMBLEDHËSE

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	655,000	-55,000	276,399	-437,153	317,291	165,633	175,812	92,303	21,721	-48,722	-3,495	17,537	-106,402	-105,351
Autoveturë tip “***”, me targa FR ***, prodhimi i vitit 1999. Blerë me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë							500,000							
Ndryshim likuiditeti	655,000	-55,000	276,399	-437,153	317,291	165,633	-324,188	92,303	21,721	-48,722	-3,495	17,537	-106,402	-105,351
B) Detyrime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C) Pasuri neto (A-B)	655,000	-55,000	276,399	-437,153	317,291	165,633	175,812	92,303	21,721	-48,722	-3,495	17,537	-106,402	-105,351
D) Të ardhura	1,022,375	1,263,593	1,325,791	1,458,737	1,155,188	1,500,608	1,710,965	1,655,608	1,698,027	1,766,579	1,805,124	2,048,247	2,019,847	2,057,138
Të ardhura nga paga subjekti I rivlerësimit	599,703	817,838	840,996	863,479	845,068	866,699	1,012,310	1,048,902	1,083,413	1,119,465	1,116,192	1,392,009	1,393,168	1,428,152
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	422,672	438,852	461,198	575,398	297,974	614,308	674,720	581,153	589,882	623,183	622,335	635,534	618,945	625,588
Të ardhura nga interesat e depozitës të subjektit të rivlerësimit		6,903	23,597	19,860	12,146	19,601	23,935	25,553	24,732	23,931	66,597	20,704	7,734	3,398
E) Shpenzime	321,592	321,592	368,671	396,060	586,480	712,780	694,480	703,480	712,480	730,096	798,096	1,113,992	1,181,399	1,246,476
Shpenzime minimale jetike	281,592	281,592	328,671	356,060	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit													41,295	54,108
Shpenzime arsimit për fëmijët						126,300	108,000	117,000	126,000	126,000	234,000	234,000	243,000	252,000
Shpenzime mobilimi	40,000	40,000	40,000	40,000	40,000	40,000	40,000	40,000	40,000	40,000				
Balanca e fondeve (D-C-E)	45,783	997,001	680,721	1,499,830	251,417	622,195	840,673	859,825	963,826	1,085,205	1,010,523	916,718	944,850	916,013